

Ekosistemi ligatinor i Butrintit është një zonë me biodiversitet të pasur, me larmi habitatesh dhe llojesh. Ka rreth 1500-2000 specie insektesh; 105 lloje peshqish; 247 specie zogjsh nga të cilët 70% janë zogj uji; 10 lloje amfibësh; 28 lloje zvarranikësh (që përfaqësojnë 60-75% të herpetofaunës së vendit) si dhe 39 lloje gjitarësh (që përfaqësojnë 60% të gjitarëve të vendit). Nga gjitarët mund të përmenden lakuriqi i natës, dhelpra, ujku, derri i egër, kunadhja, lepuri, macja e egër etj.

Rreth 140 lloje bimësh dhe kafshësh të Parkut Kombëtar të Butrintit janë me rëndësi për Ruajtje, ndërsa 35 lloje kafshësh ndër të cilët: 2 amfibë; 6 zvarranikë; 13 zogj dhe 14 gjitarë kanë interes të ruajtjes globale (IUCN, 2001).



Flora në Butrint është e pasur dhe e larmishme, e përbërë nga 800-900 specie bimësh, nga të cilat 32 bimë janë pjesë e listës të Kuqe kombëtare. 16 prej tyre konsiderohen si të Rrezikuara, 12 si të Rralla dhe 4 specie nuk njihen mjaftueshëm.

Nga llojet drunore mund të përmenden: dafina, ilqe, frashëri i zi, frashëri i bardhë, vidhi, rrenja, valanidhi, caraci, pralli, bulgri, qarri, shpardhi, bungëbuta, bunga, lofata, xhixhibanozi, shelgu i bardhë, shkoza e bardhë, mëlleza, gorrica, murrizi, bajame e egër, gjeshtira, driza, trendafil i egër, krekëza, bushi, marina, mersina, urthi, thana, shqopa, kočimare, ullastra, mreta, konopica, cfaka, dëllinja e kuqe, rrushkulli, kashta e kënetës etj.

Rëndësia natyrore e Ligatinave të Butrintit u njoh nga Konventa Ramsar në vitin 2002. Në vitin 2005, Butrinti u shpall Park Kombëtar.

Institucionet kombëtare dhe rajonale kompetente për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin e turizmit janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, e cila vepron në rajon përmes Agjencisë Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë.

“Më lër të të them se Butrinti është për Korkyrën (Korfuzin), ashtu siç është Antiumi për Romën – vendi më i qetë, më i këndshëm dhe më i bukur në botë”

Letër e Ciceronit drejtuar Atikusit (viti 56 para Krishtit)



Qyteti antik i Butrintit, së bashku me rrethinat, përbën një peizazh kulturor të jashtëzakonshëm, i cili është zhvilluar organikisht përgjatë shumë shekujsh. I banuar qysh në periudhën prehistorike, Butrinti ka qenë dëshmi e ngritjeve dhe uljeve të perandorive të mëdha që kanë mbizotëruar në rajon. Në bazë të mitologjisë klasike, Buthrotum u ndërtua nga mërgimtarët që ikën pasi ra Troja. Me të arritur, djali i Priamit, Helenusi, sakrifikoi një dem, i cili përpëlitej i plagosur dhe ngordhi në breg. Duke e marrë këtë si një shenjë të mbarë, vendi u quajt Buthrotum që do të thotë “dem i plagosur”.


Qyteti antik i Butrintit u përfshi në listën kombëtare të trashëgimisë si monument kulture në vitin 1948, u shpall “Pasuri Botërore e mbrojtur nga UNESCO” në vitin 1992 bazuar në Kriterin kulturor (iii) si: “... një sit që ofron vlera të qytetërimit të antikitetit dhe mesjetës në territorin e Shqipërisë” dhe kufiri i tij u zgjerua në vitin 1999.

Bordi i Parkut Kombëtar e drejtuar nga Ministri i Kulturës, është përgjegjës për menaxhimin e Pronës Pasuri Botërore. Zyra për Administrimin dhe Koordinimin e Parkut Kombëtar është përgjegjës për administrimin e zonave me rëndësi kulturore. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Instituti i Arkeologjisë janë përgjegjës për kërkimet, gjurmimet dhe konservimin e rrënojave arkitektonike dhe arkeologjike.

Printimi i kësaj fletëpalosje u mundësua me financim të projektit Mo.Na, në kuadër të programit Interreg Balkan Mediterranean 2014 - 2020. Ky projekt synon vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

<https://www.monumentnature.com/>

Interreg 
Balkan-Mediterranean
Mo.Na



Monumente në Natyrë: Një bashkëjetesë krijuese në Butrint

Butrinti është një mikrokosmos i historisë së Mesdheut. Ai përbën një peizazh magjik ku ndërthuren arkeologjia, monumentet me biodiversitetin e jashtëzakonshëm, habitatet e ndryshme natyrore, gjysmë natyrore dhe artificiale, duke dëshmuar bashkëveprimin midis njeriut dhe natyrës për mbi tre mijëvjeçarë. Ky sit me vlera universale është i rrethuar nga ujërat e Kanalit të Vivarit dhe Liqenit të Butrintit dhe i fshehur mes një bimësie të dendur. Kombinimi unik i rrënojave arkeologjike dhe bukurive natyrore krijon një atmosferë mbresëlënëse.

Me gati 17% të pasurisë së specieve të vendit, me një larmi të florës dhe faunës, Butrinti paraqet shifrat më të larta të regjistruara ndonjëherë në një kompleks ligatinor shqiptar.

Parku Kombëtar i Butrintit dallon për biodiversitetin e tij të lartë: ekzistojnë 27 lloje habitatesh, nga të cilat 5 janë habitate prioritare për Evropën. Ai renditet si një nga zonat kryesore të biodiversitetit të Mesdheut, zonë Ramsar, dhe Pasuri Botërore e UNESCO's.



Nëse shëtit brenda qytetit antik të Butrintit, është e pamundur të mos takosh breshkat e ujit *Emys orbicularis* dhe *Mauremys rivulata*, të cilat ndajnë të njëjtin habitat.

BRESHKË UJI, BRESHKUJCE (Linnaeus, 1758) - *Emys orbicularis*

Është e përhapur në Shqipëri, në zonat fushore dhe kodrinore deri në lartësinë 1000m. Gjetet në rrethina të ndryshme ujore si kënetat, kanalet, pishinat, përrrenjtë, rezervuarët e ujit, liqenet e ujërave të ëmbla si dhe në pellgjet e njelmëta afër detit. Preferon zona të pasura me bimë ujore.

Idriz. Haxhiu, *The Reptilia of Albania, Species composition, distribution, habitats, 1998*



BRETKOSA E EPIRIT - *Pelophylax epeiroticus*

Bretkosa e ujit *Pelophylax epeiroticus* është një specie e bretkosave në familjen Ranidae. Ajo është gjetur në Greqinë perëndimore, duke përfshirë Korfuzin, si dhe në zonat jugore të Shqipërisë në liqenin e Butrintit. Ashtu si shumica e bretkosave, edhe bretkosat e ujit *Pelophylax epeiroticus* tregojnë dimorfizëm seksual. Meshkujt mund të rriten në 74 mm në gjatësi, dhe femrat rriten më të mëdha deri në 84 mm. Pjesa e sipërme kurrizore është tipikisht e gjelbër me njolla të zeza të parregullta. Pjesa e poshtme është e zbehtë. Qeset vokale të meshkujve janë ngjyrë ulliri përveç sezonit të çiftëzimit, kur ato mund të kthehen në ngjyrë gri të errët.



DHËMBKRAPI I BUTRINTIT - *Valencia letourneuxi*

Peshku *Valencia letourneuxi* (dhëmbkrap) është specie endemike në pjesën perëndimore të Ballkanit dhe është raportuar në Shqipëri, vetëm në liqenin e Butrintit në 2019. Speciet janë rizbuluar në një dendësi të ulët të popullsisë (vetëm 11 individë të mbledhur) në përrua që ushqehet nga burimi në afërsi të liqenit të Butrintit. *Valencia letourneuxi*, përshihet në listën e Konventës së Bernës si specie e rrezikuar dhe e mbrojtur rreptësisht. Karakterizohet si specie prioritare për ruajtje në Shtojcën II të Direktivës së Habitave të Bashkimit Evropian 92/43/CEE. Gjithashtu klasifikohet si CR (kritikisht e rrezikuar) sipas IUCN në 1996. Pavarësisht përmasave të saj të vogla është e një rëndësie të veçantë sepse shërben si indikator i mjedisit ku rritet dhe ka një shpërndarje të ngushtë gjeografike.

Shumka S, Kalogianni E, Sonda R, Vukić J, Shumka L, Zimmerman B. 2020.



BRESHKË UJI, BRESHKUJCE (Valenciennes, 1833) - *Mauremys rivulata*

E zakonshme në Shqipërinë perëndimore në rajonet e ulëta dhe kodrinore që i përkasin rajonit klimatik mesdhetar kodrinor dhe ultësinor. Jeton në ambiente ujore me ose pa kënetë, kanale, pishina ose përrrenj, si dhe në ujë të njelmët afër detit.

Idriz. Haxhiu, *The Reptilia of Albania, Species composition, distribution, habitats, 1998*



BRESHKA MALORE (Schoepff, 1792) - *Testudo marginata*

Gjetet në Shqipërinë Jugperëndimore. Kjo specie është gjendur vetëm në vitet e fundit në disa zona në rrethin e Sarandës. Jeton në zonë në harmoni me breshkën e zakonshme (*Testudo Hermannii*). Preferon vendet me shkurre dhe bimësi, me gurë dhe shkëmbinj, dhe gjithashtu jeton në lugina me bimësi të dendur.

Idriz. Haxhiu, *The Reptilia of Albania, Species composition, distribution, habitats, 1998*



MIDHJA E DETIT TË ZI - *mytilus galloprovincialis*

Që prej vitit 1968, Liqeni i Butrintit ka kultivuar mbarështimin artificial të midhjeve të detit të zi (*Mytilus galloprovincialis*), sasia e të cilave është nga 2000 në 7000 kg për vit.

